



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

**PROÇESVERBAL**

Mbledhje e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Ditën e mërkurë, datë 16.10.2024, ora 15:00 në ambjentet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u mbajt mbledhja e dytë e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile për vitin 2024. Anëtarë të pranishëm në mbledhje ishin:

Për anëtarët përfaqësues të institucioneve publike:

1. Znj. Albana Koçiu – Ministre – Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
2. Z. Tedi Dobi – Zv/Ministër - Ministria e Drejtësisë
3. Z. Albin Gega - Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
4. Znj. Elona Bano – Ministria e Drejtësisë
5. Znj. Ilva Gjuzi – Zv/Ministre - Ministria e Turizmit dhe e Mjedisit
6. Znj. Denada Seferi –Zv/Ministre - Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
7. Znj. Sara Kapoli - Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët
8. Znj. Nina Guga – Zv/Ministre, Ministria e Arsimit dhe Sportit
9. Z. Andi Kananaj – Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
10. Znj. Marjana Shehi – Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural

Për anëtarët përfaqësues të shoqërisë civile në Këshill:

1. Z. Vladimir Thano –N/Kryetar i Këshillit
2. Z. Indrit Seferi
3. Znj. Eglantina Bardhi
4. Z. Nensi Dragoti
5. Z. Gentian Sejrani
6. Znj. Fabiola Laço Egro
7. Z. Xhimi Vila

Përfaqësues nga AMSHC:

1. Znj. Eniana Koçiaj
2. Znj. Andia Ndreka
3. Z. Erion Banushi

Pjesëmarrës të tjerë:

1. Znj. Eridana Çano – Drejtoreshë Ekzekutive – Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)
2. Z. Arban Morina – SASPAC
3. Znj. Alda Duriçi – SASPAC
4. Z. Marjus Borokoçi – SASPAC
5. Znj. Blerina Balla - OSCE
6. Z. Elton Lelo – OSCE
7. Znj. Natasha Mazari – EU TACSO

## **Agjenda e takimit:**

1. Fjala e hapjes dhe aprovimi i rendit të ditës – *Znj. Albana Koçiu*
2. Përditësim mbi Udhërrëfyesin e ri të Shoqërisë Civile dhe Ndryshimin e Ligjit të KKSHC-  
*MSHMC*
3. Miratimi i Udhërrëfyesit të Ri mbi Institucionet Demokratike – *Znj. Elona Bano, Ministria e Drejtësisë*
4. Proçesi integritit të Shqipërisë në BE, roli i organizatave të shoqërisë civile në këtë proçes dhe në përfshirjen e Komitetit të Përbashkët Konsultativ të shoqërisë civile. - *Ministria e Shtetit dhe Kryenegociatore*
5. Bashkëfinancimi publik për projektet e BE-së dhe formulari i përjashtimit nga TVSH për projektet e financuara nga BE - *Znj. Eridana Çano, Drejtoreshë e Përgjithshme, SASPAC*
6. Propozime mbi krijimin e Urdhërit të Profesionit të Shëndetit Publik - *Z.Indrit Seferi, anëtar i KKSHC*
7. Diskutime

### **1. Fjala e hapjes dhe aprovimi i rendit të ditës**

#### **Drejtton Mbledhjen Znj.Albana Koçiu, Kryetare e KKSHC-së:**

**Znj. Albana Koçiu** - Përshëndetje, faleminderit shumë për prezencën. Nisim mbledhjen e dytë të Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile për vitin 2024. Ju, besoj e keni marrë të gjithë agjendën në dorë për këtë mbledhje, megjithatë nëse ka propozime apo ide shtesë në rendin e ditës është i mirëpritur që ta diskutojmë, nëse jo e konsiderojmë të miratuar agjendën për sot.

Nga diskutimet që kemi patur paraprakisht edhe me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile por edhe me stafin apo strukturën këtu, nisur dhe nga minutat e takimit të fundit ka dalë si nevojë apo si domosdoshmëri për t'u trajtuar në këtë Këshill edhe proçesi i negociatave për Bashkimin Evropian nga zyra e Kryenegociatorit. Për shkak të zhvillimeve më të fundit e kishim të pamundur për të siguruar sot praninë e zyrës së Kryenegociatorit që do të thotë do ta lëmë në takimin e rradhës. Ndërkohë kemi një prezantim nga Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë për Udhërrëfyesin mbi Funkionimin e Institucioneve Demokratike. Kemi praninë e SASPAC - Drejtoreshën e Përgjithshme të Agjencisë, znj. Eridana Çano. Shumë faleminderit që na u bashkove sot, duke ditur ngakesën që keni në agjendën tuaj. Ndërkohë në fund të agjendës kemi lënë një propozim që na vjen nga z. Indrit Seferi mbi krijimin e Urdhërit të Profesionit të Shëndetit Publik. Në fakt ky është një diskutim që ka kohë që kryhet, por meqenëse kemi marrë një propozim konkret të shkruar do ta ftonim që të na bënte shkurtimisht një prezantim lidhur me propozimin e dërguar. Më pas të diskutojmë dhe të dakortësojmë në vijim.

Ndërkohë pikë të parë të rendit të ditës ne kishim përditësim lidhur me Udhërrëfyesin për Shoqërinë Civile, një takim i parafundit nëse quajmë këtë të fundit, sepse do të bëjmë dhe një tjetër më zyrën e Kryenegociatorit - në takimin pararendës ne bëmë një diskutim dhe një prezantim nga Zv.Ministrja Znj. Denada Seferi, për monitorimin që i kështë kryer Udhërrëfyesit ekzistues gjithsesi Denada do të ta jap fjalën shkurtimisht për të bërë përditësime në lidhje me çfarë kemi realizuar deri tani dhe kush janë planet apo masat konkrete që ne presim të bëjmë në vijim në vazhden e Udhërrëfyesit të ri. Në fakt do të na ndihmonte në diskutim edhe

prania e zyrës së Kryenegociatorit ose të përfaqësuesve të Kryeministrit. Ka një diskutim mes nesh në lidhje me përgjegjësitë dhe funksionet në këtë drejtim, besoj që do të marrë zgjidhje shumë shpejt. Unë, personalisht, kam bërë një diskutim edhe vetë me Kryenegociatoren dhe me zyrën e Kryeministrit për ta ndarë përgjegjësinë dhe për të ngritur strukturën e dedikuar që ndoshta do të lehtësojë, jo ndoshta por jam e bindur që do ta lehtësojë dhe komunikim mes nesh dhe do ta bëjë më aktiv. Do i kaloj fjalën znj. Denada Seferit pastaj vijojmë sërish.

**Znj. Denada Seferi** – Faleminderit Zonja Ministre. Në fakt shumë shkurt, ne të gjithë së bashku kemi qenë po në këtë tryezë kur kemi prezantuar raportin e vlerësimit të Udhërrëfyesit për periudhën 2019-2023. Ky raport monitorimi na është prezantuar nga eksperti i delegacionit evropian, i cili na është atashuar për të riparë dhe mundësinë e hartimit të një Udhërrëfyesi të ri. Unë nuk kam çfarë t'i shtoj kësaj sepse Ministria na shpjegoi që ne duhet të kemi një takim të posaçëm edhe me Kryenegociatoren dhe me stafin e saj në mënyrë që të diskutojmë dhe më tej të shikojmë edhe qasjen që ata kanë në lidhje me çështjen e Udhërrëfyesit por mbi të gjitha dhe të ndryshimeve që ndërmarrim edhe për ligjin e KSSH-së. Kështu që mendoj se ne i kemi të ezauruara të gjitha çështjet sëbashku pikërisht në mbledhjen e 4 Qershorit të këtij viti ku u prezantua raporti i monitorimit. Faleminderit!

**Znj. Albana Koçiu** – Ndërkohë, përsa i përket hartimit të Udhërrëfyesit të ri kemi informacion? Apo ky proces do të ndahet në momentin që ne do të kemi të qartë kush do të jetë institucioni që do ta udhëheqë?

**Znj. Denada Seferi** - Ne kemi Znj.Ministre, ekspertizën e delegacionit evropian. Ata janë ekspertë, të cilët janë të përzgjedhur nga TACSO dhe janë në pritje të rifillimit edhe njëherë të gjithë proceseve sepse mbi të gjitha janë proceset konsultative ato të cilat do të vijojnë për hartimin e Udhërrëfyesit të ri. Tani jemi në pritje të këtij procesi.

**Znj. Albana Koçiu** – Kjo është një çështje pak burokratike por që në thelb do të na garantojë që strukturat të jenë të qarta, përsa i përket dhe komunikimeve që do të ndajmë pastaj bashkarisht për vijimin e procesit. Pra, duket si diçka burokratike por që në fakt për ne së brendshmi është thelbësore për të qartësuar kush bën çfarë, kur, dhe përgjegjësitë përkatëse, detyrat, angazhimet dhe produktet që priten nga secila nga palët. Do t'ja jap fjalën tani Zotit Dobi, për të na bërë një prezantim shkurt mbi Udhërrëfyesin e Ri që është hartuar për Funksonimin e Institucioneve Demokratike. Ne fakt një Udhërrëfyes i rëndësishëm, unë mbaj mend kur i lashë në procesin e hartimit ishte goxha sfidues edhe për të marrë ngakesën edhe peshën. Shumë urime që ja dolët edhe keni bërë një punë fantastike që në fakt e meriton gjithë ekipi dhe gjithë institucionet që u përfshinë, por veçanërisht ju si Ministri e Drejtësisë sepse e keni koordinuar në mënyrë dinjitoze.

**Z. Tedi Dobi** – Faleminderit Znj. Ministre, në rradhë të parë kam kënaqësinë që jam mes jush ardhur nga tryeza e Ndërqeveritare në Luksemburg, ku u hap tashmë Grup-Kapitulli i parë i Themeloreve që është nga instrumentet më të rëndësishme, që ndonëse në mënyrë zyrtare nuk ishte piketë hapëse, por ishte më shumë i kërkuar apo i nevojshëm për këtë fazë. Kështu ka qenë gjithashtu edhe miratimi nga shteti shqiptar i Udhërrëfyesit për Funksonimin e Institucioneve Demokratike. Siç ju e thatë ka qenë një punë voluminoze nga Ministria e Drejtësisë dhe nga të gjitha institucionet e tjera. Marr parasysh që ky është një instrument gjithëpërfshirës që ka jo pak po 128 masa, nga e cila kemi 31 masa ligjore ose publike, 47 masa administrative dhe 50 masa performance të cilat janë të shtrira në periudha afatshkurtër deri në 2025, afat mesëm deri në 2027 dhe afatgjatë deri në 2030. Në term dhe në përmbajtje të tij prek elemente shumë të rëndësishme të shtetformimit dhe funksionimit të shtetit shqiptar, siç është procesi zgjedhor ku fokusohet në ngarkimin e zgjedhjeve të ndershme, planifikimin e zgjedhjeve të lira, pavarura, pluraliste dhe jotranzitore.

Kritere dhe kushte për financimin publik dhe privat të partive politike. Fuqizimi i funksionit të parlamentit në rolin mbikqyrës, legjislativ por edhe në terma të administrimit, funksionit të tij dhe ajo që është po aq e rëndësishme në mos një nga elementët më sfidues është dhe fuqizimi i rolit të shoqërisë civile nëpërmjet rishikimit të kuadrit të përgjithshëm ligjor kushtuar shoqërisë civile duke siguruar gjithëpërfshirjen gjatë procesit të bërjes në tërësi dhe prçesit të integritimit evropian. Gjithashtu kemi parashikuar masat konkrete për mbështetje të organizatave të shoqërisë civile të përfshira në kuadrin fiskal të favorshëm. Element tjetër i rëndësishëm që ia vlen të përmendet është që Ministria e Drejtësisë ka koordinuar, por të tërë kemi qenë pjesë e formësimit të tij, ku ka pasur një numër të madh takimesh të koordinuara nga 43 anëtarëve të grupit institucional të grupit të punës por kanë qenë edhe 5 tryeza konsultimi me 48 përfaqësues të shoqërisë civile. Nga procesi i konsultimit formal në platformë kemi pasur 21 komente ardhur nga 5 organizata të shoqërisë civile dhe gjatë gjithë këtij procesi janë zhvilluar diskutime prezantime në mbledhjet e kaluara të këtij Këshilli.

Si përfundim element tjetër shumë i rëndësishëm ka qënë dhe një bashkëpunim shumë i ngushtë me Komisionin Evropian me takime të zhvilluara, të cilat na kanë sjellë tashmë në këtë moment ku ne jemi. Përsa i përket rolit të shoqërisë civile ky Udhërrëfyes, ka disa elemente specifike që lidhen me Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile për këtë arsye do të doja të bëja një citim të shkurtër. Pra, rishikimi i ligjit për KKSHC-në të cilin ne e kemi marrë përsipër për ta përfunduar brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025, bashkëpunimi i rregullt dhe efektiv midis qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile, i cili është një proces që ne po e mundësojmë sikurse edhe elementët e tjerë të cilat i preka dhe që janë të këshilluara të jenë në Udhërrëfyes do të jenë tashmë elementi që do kalojë në parlament. Misioni është shumë ambicioz por është i arritshëm. Faleminderit.

**Znj. Albana Koçiu** – Shumë faleminderit. Absolutisht që të gjitha masat që janë aty në fakt janë shumë impenjative, gjithashtu i gjithë procesi është impenjativ. Vërtet ne kemi për momentin, dhe jam e sigurt nuk do na zgjasë shumë kjo euforia dhe kënaqësia e të marrit një lajmi të mirë, por ndërkohë patjetër gjithë procesi mbropa është shumë impenjativ, kërkon energji, kërkon patjetër kapacitete edhe dedikimin e duhur e të gjithëve. Kjo që sapo thatë lidhur me ligjin është një angazhim shumë i madh. Ne na keni në dispozicion dhe këdo në këtë tryeze e keni në dispozicion nëse mund të asistojë dhe besoj se mund të asistojnë dhe me dije dhe me çfarë njohurish dhe eksperiencë të mëparëshme kemi por besoj se do të duhet dhe të jemi të gjithë të qartë lidhur me angazhimet që do të kemi gjithsecili dhe afateve për tu përshtatur pastaj dhe me agjendat e secilit.

**Z. Vladimir Thano** – Faleminderit Znj.Kryetare, doja t'ju uroja mirëseardhjen në këtë Këshill meqenëse është hera e parë në mbledhjen e plotë dhe formale të Këshillit. Është krejtësisht normale pasi dhe për vetë historikun e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile, bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve publike dhe shoqërisë civile mbetet një pikë fokale për angazhimin dhe zhvillimin e shoqërisë civile. Shoqëria civile shpesh herë ka marrë pjesë në ndryshime esenciale dhe thelbësore të shoqërisë shqiptare por duke ardhur te roli i Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile ku unë mund të jem nga veteranët në anëtarësi por në rolin si nënkryetar i KKSHC, është privilegj të punosh me autoritete publike, është privilegj të përfitosh nga eksperiencat e autoriteteve publike por gjithashtu është një angazhim i madh në kuadër të shoqërisë civile jo vetëm për të sjellë zërin e shoqërisë civile por edhe problematikat që në fakt nuk janë të pakta, janë problematika që lidhen kryesisht me aspektin ekonomik dhe social, por janë gjithashtu problematika që lidhen dhe me vetë funksionimin e shoqërisë civile. Në fakt, dy konstatime përsa i përket rolit të SASPAC-ut në KKSHC është në bindjen tonë dhe të anëtarëve të tjerë të Këshillit nga shoqëria civile që SASPAC-u të jetë jo vetëm pjesë integruese në Këshill por edhe me legjislationin që do të krijohet rishtazi duke pas

parasysh çfarë pune e konsiderueshme është bërë, SASPAC-u duhet të ketë një vend si anëtar në Këshillin Kombëtar të Shoqërisë Civile. Pavarësisht problematikave që ka sjellë legjislacioni duke qenë se ministrinë kanë ndryshuar edhe këtu në ligj janë reflektuar ministri të tjera dhe në fakt ndryshimet kanë qenë të shpeshta dhe ligji nuk e ka parashikuar këtë. Kam përshtypjen që roli i SASPAC-ut është shumë i rëndësishëm në këtë aspekt.

Ndërkohë në lidhje me procesin e ligjbërjes unë di që edhe OSBE (OSCE) e ka kërkuar të ketë një rol në këtë proces duke angazhuar një ekspert, ku kanë bërë një thirrje publike për ekspertizë në lidhje me legjislacionin ose me amendimet e ligjit të ri për rolin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile dhe natyrisht jemi të gatshëm dhe të hapur për të ndihmuar në substancë, në materie atë që e bën rolin e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile më aktiv dhe dinamik, por edhe duke qenë le të themi realist me veten. Sepse jo shpeshherë gjërat na kanë funksionuar shumë mirë. Kjo ka të bëjë me faktin që nëse ne shohim me vëmendje ligjin dhe shikojmë detyrat që ka KKSHC si organ kolegjal këshillimor pranë Këshillit të Ministrave i cili duhet të raportojë çdo 6 muaj për iniciativat e marra duke pas parasysh dhe ekspertizën ndoshta joadekuat në çdo fushë tonë sepse nuk mund të jemi ekspertë dhe në gjurmëzimin e ligjit ne kemi të bëjmë pikërisht me formulat të cilat sjellin të mira publike, strategji dhe prandaj është shumë e rëndësishme që Këshilli Kombëtar i Shoqërisë Civile të ketë një rol adekuat dhe realist. Kjo është shumë e rëndësishme për t'u mbajtur parasysh nga legjislacioni, sepse shpesh herë jemi vënë në pozitë të vështirë edhe nga shoqëria civile që na ka sjellë këtu, sepse ne vijmë nga një proces votimi ku shpesh herë na besojnë që ne sjellim zërin e tyre këtu. Pra, ne jemi si sanduic, edhe këtej edhe andej, ndërkohë që është shumë e rëndësishme që të gëzohet një respekt i gjithanshëm dhe kjo është ajo që KKSHC do të sjellë si frymë dhe unë mendoj që është një frymë që ne jemi munduar ta sjellim. Dua të falenderoj dhe Kryetaren paraardhëse, në fakt e cila ka patur një rol shumë proaktiv në mbledhjet e fundit pavarësisht edhe debateve që kemi patur. Kjo na ka ndihmuar që të gjithëve bashkë të rritemi. Për këto dy çështje kjo ishte ndërhyrja ime. Faleminderit.

**Znj. Albana Koçiu** – Nënkyetar shumë faleminderit por më duket sikur ne po takohemi për herë të parë, ndërkohë ne nuk po takohemi për herë të parë. Këtë e kam edhe si formë vërejtje, nuk ka pse sa herë të takohemi ta nisim nga e para sepse po këtë diskutim kam dëgjuar dhe një vit më parë që do të thotë kjo nuk është mirëseardhje por është një takim pune që ne e bëjmë pa diskutim në mënyrë periodike se unë nuk besoj se ka ndonjë të pranishëm këtu që në një mënyrë apo në një tjetër nuk jemi takuar, kështu që le ta vijojmë diskutimin si një diskutim që vazhdon dhe jo si një çështje që nuk ka ekzistuar më parë.

Ndërkohë përsa i përket funksioneve apo prezencës së një Institucioni apo një tjetre patjetër që organizimi i administratës shtetërore është dinamik. Ajo që është siguruar besoj unë fort këtu është që të përfaqësohen çështje apo institucione pavarësisht emërtesave që kanë. Por është mirë edhe të diskutohet se deri dje funksionet e SASPAC-ut kanë qenë të organizuara mes Kryeministrit dhe Ministrisë së Financës. Sot kemi një institucion të dedikuar që organizohet pak më ndryshe por që patjetër nuk besoj se është problemi nëse e bëjmë pjesë të Këshillit apo jo, ne sigurojmë se sa herë që kemi çështje që do të duhet të diskutohen me praninë e përfaqësuesve të SASPAC patjetër do ta kemi prezent dhe jo pa qëllim edhe e falenderova drejtoreshën që gjeti një hapsirë, se realisht koha ku jemi është e ngarkuar për shkak edhe të programimit të fondeve të huaja që do ta shpjegojë pak edhe Znj. Çano vetë. Ne ndërkohë e kemi thirrur këtu pikërisht për një nga çështjet që na ka shqetësuar prej kohësh dhe ne kemi bërë diskutim edhe më parë, apo një diskutim që ka vijuar të jetë pak edhe i tejmbartur në kohë, që ka të bëjë pikërisht me bashkëfinancimin publik për projektet e BE-së dhe formularin e përjashtimit nga TVSH-ja për projektet e financuara nga BE-ja që është një diskutim që ka vite që bëhet.



**Znj. Eridana Çano** – Shumë faleminderit Kryetare, shumë faleminderit Ministre, është kënaqësi e jashtëzakonshme të jem pjesëmarrëse në këtë Këshill. Unë kam qenë gjithmonë dhe do të vazhdoj të mbetem shumë aktive në suportin që shoqëria civile duhet të ketë në Shqipëri, jo vetëm nga ana politike por edhe nga ana e mbështetjes financiare dhe mendoj e besoj që shoqëria civile është një gur themeli që na ndihmon të gjithëve përsa i përket proceseve të reformave, aq më tepër tani që jemi në rrugëtimin e përbashkët dhe nuk kemi si ndahemi deri në 2030. Me një gur kilometrik të përmbushur ditën e djeshme me hapjen e kapitullit 1. Që në ditën e parë që kam hyrë dhe kam futur këmbët në SASPAC, çështja e TVSH-së ishte çështja e ditës, vazhdon të jetë e tillë por jam këtu për të ndarë lajmin e mirë që kemi progres me të edhe keni angazhimin tim të plotë por edhe të ekipit që unë drejtoj dhe përfaqësoj që kjo gjë do të jetë çështje dite për ta zgjidhur dhe pastaj për ta adresuar ku mund të ketë problematika. Kështuqë në këtë Këshill unë vi me qejf sa herë të më thërrisni nga ana e SASPAC-ut do keni një rol proaktiv.

**Znj. Albana Koçiu** – Më falni shumë që po ju ndërpres. Ndërkohë keni edhe një funksion të dyfishtë sepse jeni dhe anëtare e Bordit Drejtues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

**Znj. Eridana Çano** – Po, do ta thoja po e lashë në momentin e fundit. Po jam anëtare në Bordin Drejtues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile. Pra, do të kemi një rol super aktiv dhe ju lutem do të doja të dëgjoja edhe më shumë nga ju, dhe jo vetëm në takimet e Këshillit por edhe në takime që ju mund të kërkonin në SASPAC me mua me kolegët për të ngritur këto problematika. Jemi në dijeni të disa problematikave që bashkëshoqërojnë çështjen e TVSH-së. Po e nis me TVSH-në dhe më pas do t'ju jap disa informacione që lidhen me pjesën e financimeve para se ne të futemi në antarësim të plotë.

Që nga momenti i parë që na ka ardhur si diskutim, unë kam kërkuar te Ministria e Financave dhe tek Drejtoria e Tatimeve që problemi të rishikohet. Të rishikohet me një qasje dyshe. E para, për të kuptuar cilat janë problematikat që e shoqërojnë procesin nga momenti që OJF-të vijnë dhe duhet të jenë të përjashtuara nga tatimi që në burim - di që udhëzimi është i qartë por ngec kur shkon tek administrata tatimore dhe ka 100 problematika me të cilat OJF-të përballen. Gjithashtu edhe për të kuptuar se çfarë mund të ndryshojmë në rrjedhën e këtij udhëzimi për ta bërë atë sa më të qasur si nga ana e donatorit ashtu edhe nga ana e përfituesit që në këtë rast janë OJF-të. Pra, udhëzimi është duke u riparë. Kemi marrë mendimet e para, ndryshimet e para të propozuara nga Ministria e Financave dhe sëbashku me administratën tatimore kemi bërë disa takime me ta, edhe sepse në takimet që duhet të ndiqnim ngaqë ishte protokollin me Gjermaninë, që u finalizua javën e shkuar, edhe ata kanë shumë më tepër problematika sesa ju, me besoni, përsa i përket reduktimit të TVSH-së. Por mbetemi te pjesa e përjashtimit të TVSH-së që në burim. Ky udhëzim i cili është duke u punuar edhe me ekipin e SASPAC-ut dhe besoj se avokatë më të mirë sesa janë këta djem dhe vajza pas meje nuk do keni, po e finalizojmë duke parë të gjithë problematikat që ne kemi dëgjuar por do të dalë dhe për konsultim. Pra do të bëjmë një takim konsultativ me Ministrinë e Financave dhe do t'ua japim këtë udhëzim të ndryshuar të gjithë donatorëve të cilët do ta ndajnë dhe me ju dhe ne. Kështuqë ju do të vini dhe do të na thoni ato problematika që ju i shihni të cilat nuk janë ende të reflektuara në udhëzim, në mënyrë që çështja kur të vini të kërkonin përjashtimin nga tatimi të vijë në mënyrën më të mirë të mundshme. Ajo që normalisht unë jam angazhuar dhe besoj se do ta kryej në një kohë shumë të shpejtë, duke qënë se edhe qeveria shqiptare është angazhuar në proceset e dixhitalizimit, është marrja e këtij shërbimi nga institucionet shtetërore online. Pra, që të mos mundoheni njëherë me gjithë kopicën e letrave, të vini njëherë në SASPAC, të merrni atë kartonin e verdhë që e lëshon Drejtori i Përgjithshëm, pastaj e çoni te tatim-taksat për të bërë të njëjtën procedurë dhe ata kërkojnë një sërë dokumentash, jemi duke folur me AKSHI-in por dhe me Ministrinë e Financave dhe me tatimet që ky të jetë një shërbim online në e-albania. Kështu OJF-të futen dhe bëjnë gjithë procesin e identifikimit dhe të dhënies së dokumentave. Ne u vëmë vulën paraprake, që t'ju

njohim si marrësit e shërbimit dhe pastaj procesi do të shkojë te tatimet dhe tatimet t'ju japin çertifikatën e përjashtimit nga taksat. Me këtë çertifikatë, tatimet tani kanë për detyrë të edukojnë të gjithë furnizuesit e mëdhenj që çertifikatën e cila besoj do të dalë shumë shpejt në formatin elektronik, ta njohin dhe të mos bëjnë problematika të tjera për njohjen e saj. Në këtë luftë të vogël, jemi bashkë. Do t'ju lutesha sa më shumë që t'ju kem nga kjo ana e gardhit për t'i mbushur mendjen të gjithë kolegëve që janë pjesë e tavolinës që udhëzimi të bëhet dhe mjaft më me ndryshime pafund që duket sikur kemi një kovë që vetëm kullon por nuk zgjidh problem. Prandaj do të doja shumë që në procesin e amendimit të udhëzimit të Ministrit të Financave të jemi të gjithë shumë vizionar, që të kuptojmë çfarë problematikash duhet të zgjidhim tani dhe në të ardhmen.

**Znj. Albana Koçiu** – Që të rrimë në këtë çështje dhe ta bëjmë pak më konkrete, për shkak se unë e thashë dhe në fillim, kam një vit që e dëgjoj këtë dhe nuk di se sa kohë më parë kanë përfaqësuesit që janë në këtë tryezë që e kanë këtë shqetësim dhe ashtu siç e the dhe me të drejtë që në ditën e parë që u ule në tryezë e dëgjove si shqetësim. Së pari, fakti që ka ca kohë që diskutohet, pra ka marrë kohë - nuk e di por ka shumë arsye pse mund të marri kohë, ndoshta për arsye angazhimi apo se në një moment të caktuar nuk ka ardhur koha për t'u bërë kjo gjë. Ajo që dua të them është se ne duhet të kemi pranë SASPAC-ut një strukturë apo ekip apo një person të dedikuar për këtë gjë, së dyti ne do na duhet që nëse kemi një draft të parë ta konsultuar me qëllim që edhe anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shoqërisë Civile të kenë mundësinë të japin sugjerimet e tyre për problematikën që patjetër i kanë patur dhe i kanë adresuar këtu më parë, kështuqë janë të interesuar të kuptojnë se deri në çka pike kemi shkuar. Kjo do të na bënte mirë si ushtrim edhe për të kuptuar kur mund të kemi një finalizim të këtij problemi dhe secili nga ne të japë një dorë apo të llobojë që gjëja të përfundojë sa më shpejt.

**Znj. Eridana Çano** – Keni shumë të drejtë Znj.Kryetare, dhe për të vënë disa afate, ne brenda kësaj jave po tentojmë ta mbyllim me Ministrinë e Financave. Do të kemi dhe në plan siç ju thashë dhe më parë një takim konsultativ, që nëse nuk e bëjmë deri të premten për çfarëdo lloj arsyeje objektive, deri në fund të javës së ardhshme amendimet apo sugjerimet do të jenë gati dhe do t'ju shpërndahen. Do t'ju shpërndahen dhe donatorëve dhe ju si Këshilli Kombëtar, dhe Ministrive që të kemi mendime të integruara nga ana juaj. Këtë proces, të ishte për mua, do ta kisha mbyllur brenda tetorit, dua ta mbyllim sa më parë edhe pse kemi marrë angazhim që në Protokollin e Bashkëpunimit me Gjermanët kjo problematikë të mbyllet brenda 2024.

**Znj. Albana Koçiu** – Ky po është lajm i mirë.

**Znj. Eridana Çano** – Tani, shumë shpejt dhe po i referohem vetes, se jam ende e re dhe nuk dua që të bëj gabime por e di që mendimet apo informacionet që më kanë dhënë kolegët, përsa i përket pjesës së financimit janë shumë të rëndësishme, kështuqë do i lexoj. Në kuadër të asistencës financiare të disa skema grantesh për financim të shoqërisë civile që janë të menaxhuara drejtpërdrejt nga delegacioni i Bashkimit Evropian. Ndoshta janë informacione që ju i keni por, unë po jua risjell në kujtesë dhe në vëmendje. Vetëm një numër i kufizuar i kontratave që përfitohen nga shoqëria civile janë të menxhuara drejtpërdrejtë nga Shqipëria, nëpërmjet CFCU-së me një fushë veprimtarie shumë të kufizuar. Pra, këtu jemi të qartë që gjëja më e madhe e projekteve të BE-së është e menaxhuar nga vetë ata, ne kemi shumë pak edhe në kapituj. Të vetmet fonde të BE-së IPA III që janë ende në programim janë skema grante për pushtetin lokal, të cilat dhe këto janë prapë të kufizuara dhe fondet të cilat janë pjesë e instrumentit të Planit të Rritjes (Growth Plan) që programohet nga zyra e Kryeministrit bashkë me atë të Kryenegociatores, përmes pjesës Axhendës së Reformave (Reform Agenda). Këtu Znj.Ministre është shumë në dijeni të procesit, sepse është edhe vetë një nga institucionet që duhet të jetë pjesë e Axhendës së Reformave dhe Planit të Rritjes.



Një mundësi konkrete për *Agjencinë*, tani do të jap disa referenca apo sugjerime, është krijimi i një rrjeti konsultativ të Agjencive për Shoqërinë Civile në bashkëpunim me organizata të ngjashme në vendet anëtare të BE-së. Ky rrjet mund të forcojë marrëdhëniet me Parlamentin Evropian, Këshillin e Evropës dhe Komisionin si dhe të aplikojë për financime. Përveç kësaj, sigurisht të gjithë keni mundësinë që aktivisht të shohim financimet nëpërmjet programeve ndërkufitare, pra ato që quhen Interreg, të cilat SASPAC-u i ka në administrim kështuqë është një derë e hapur për ju çfarëdo që ju duhet, si unë ashtu edhe kolegët e mi jemi të gatshëm të japin informacion. Ndërkohë, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është e përfshirë zyrtarisht si pjesë e grupit të punës në Kapitullin 22, ndër të tjera. Kapitulli 22 është kapitulli që në momentin kur bëhesh shtet anëtar në BE, çelen fonde strukturore të cilat ndihmojnë shtetin që të rritet e të fuqizohet si një shtet anëtar. Kjo do të përfshijë forma të zbatimit të programit dhe të kalimit të partneritetit për politikën e kohezionit të BE-së, i cili identifikon organizatat e shoqërisë civile si partnere për përgatitjen dhe zbatimin e fondeve, te atyre fondeve strukturore që unë përmenda.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile duhet të marrë pjesë aktive, duke përfshirë dhe organizatat shoqërisë civile të cilat janë sektoriale në çdo grup pune programimi, që do të krijohet për programimin e fondeve të politikës së Kohezionit të BE-së përmes programeve, projekteve madhore, të cilat kanë rëndësi strategjike dhe nëpërmjet skemave të granteve. Në lidhje me këtë AMSHC duhet të pozicionohet në strukturat e partneritetit të krijuara në politikën e kohezionit të BE-së në përputhje me Kodin e Evropian të sjelljes së partneritetit që është pjesë e Kapitullit 22. Grupi i punës për Kapitullin 22, Platforma e Partneritetit dhe zbatimit të urdhërit të Kryeministrit të vitit 2019, duhet të ketë një platformë partneriteti për çdo grup pune. Platforma e partneritetit duhet të përfshijë përfaqësues të shoqërisë civile dhe thirrja për shprehjen e interesit është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, të cilët kanë shprehur interes 3 organizata të shoqërisë civile. Ky është një informacion i përmbledhur, që besoj se dhe z. Kananaj mund të japë më tepër informacion për situatën, por ajo që unë do të doja të theksoja nën opinionin tim si drejtuese e SASPAC-ut dhe gjithashtu dhe negociatore për Kapitullin 22, që është një Kapitull jashtëzakonisht shumë i rëndësishëm. Strukturat apo shërbimet e Komisionit Evropian janë duke punuar në mënyrë intensive me ne dhe me të gjithë anëtarët e grupit të punës, në një takim para dy javësh për të bërë Shqipërinë gati, sepse duhen përmbushur kushtet paraprake (enabling conditions), disa prej të cilave janë të detyrueshme dhe që janë 4 horizontale të cilat ne duhet të fokusohemi shumë mirë në mënyrë që pastaj të kemi çeljen e fondeve. Në këtë moment nuk jemi shumë të interesuar sepse nuk janë gjëra nga të cilat do të përfitojmë sot dhe nesër, por ajo dera që do të hapet shumë shpejt nuk është aq larg. Domethënë koha kalon kështuqë ne duhet të ecim.

Përsa i përket *Pakteve të Integritetit*, është nisur një thirrje e re për organizatat e shoqërisë civile për të krijuar një hapësirë mbështetëse/ndihmuese “help desk” për Paktin e Integritetit, kjo është e hapur për të gjitha organizatat e shoqërisë civile në shtetet anëtare. Pas projektit pilot të Paketave të Integritetit të mbështetur nga Komisioni Evropian, 15 shtetet anëtare janë të ftuara të zbatojnë dhe inkurajojnë Paktet e Integritetit. Nisur nga kjo praktikë në vendet e BE-së, potencialisht AMSHC mund të krijojë një model ose të promovojë pilotimin e një Pakti të Integritetit në Shqipëri që do të zbatohet për zbatimin e politikës së Kohezionit. Për këtë mund të kërkohet ndihmë nga Komisioni, nga Delegacioni dhe këtu, potencialisht mund të organizohet diçka nëpërmjet instrumentit TAIEX (Technical Assistance and Information Exchange) mbi Paktet e Integritetit nën iniciativën dhe me bashkëpunimin e një institucioni publik. Kështuqë kjo është përsëri për Z.Kananaj për t’u marrë parasysh. Një Plan Integriteti është një mjet i transparencës dhe i përgjegjshmërisë, rrit besimin te autoritetet dhe kontraktimet qeveritare, kontribuon në reputacionin e mirë të autoriteteve kontraktore, sjell reduktime në kosto dhe konkurrencë të përmirësuar nëpërmjet përfundimeve më të mira.

Për të siguruar llogaridhënien, Pakti i Integritetit përfshin gjithashtu një sistem të pavarur monitorimi të udhëhequr nga shoqëria civile. Në thelb Pakti i Integritetit ka dy komponentë dhe përfshin 3 palë.

Një statut nëpërmjet një autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik që prokurojnë për kontrata publike dhe ata që do të abstenojnë nga praktikatat korruptive do të kryejnë një proces konkurimi transparent. Një kontratë e vecantë me një organizatë të shoqërisë civile e cila monitoron të gjitha palët për të siguruar llogaridhënine dhe legjitimitet. Kur thuhet kështu duken të ngatërruara, e di që hap pas hapi, megjithëse Kapitulli 22 është një kapitull i paeksploruar edhe nga ne, të ecim përpara.

Shumë faleminderit Ministre – ne na keni këtu për çdo gjë që ju nevojitet.

**Znj. Albana Koçiu** – Shumë faleminderit Eridana, unë besoj se të gjithëve ne na vjen mirë kur shikojmë që institucionet janë mbështesëse jo vetëm të shoqërisë civile por edhe ndaj portofolit tonë të përbashkët për të punuar dhe shtyrë gjërat përpara. Kur ka dëshirë dhe vullnet për të shtyrë gjërat përpara, pa diskutim që çdo gjë bëhet më e lehtë. Po vazhdojmë edhe me pikën tjetër të Axhendës e më pas hapim diskutimet.

**Z. Indrit Seferi:** Pëshëndetje, do bëj një prezantim të shkurtër. Në Republikën e Shqipërisë në vitin 2007 futen për herë të parë politikat për formimin e profesionistit të shëndetit publik, dhe në vitin 2010 dhe 2012 dalin ekspertët e parë për të punuar në këtë profesion. Në momentin e hyrjes në profesion, siç ndodh me të gjithë profesionistët e shëndetësisë të cilët licensohen, pra që konsiderohen si profesione të rregulluara me ligj, këtij specialiteti nuk i krijohet mundësia për t'u futur në këto kategori. Arsyet janë të ndryshme por ideja është që nga 2012 e deri tani ka lindur nevoja që ky profesion të hyjë tek profesionet e rregulluara me ligj. E para për nga rëndësia, ne u përballëm edhe me kontekstin e pandemisë ku kërkonte integrimin e të gjithë profesionistëve dhe ekspertizat e shumta që jep eksperti i shëndetit publik, dhe le të themi do të duhet një mbështetje adekuate institucionale për të rregulluar marrëdhënien e këtij profesioni me institucionet publike dhe jopublike të Republikës së Shqipërisë.

Ndërkohë unë kam sjellë edhe një shembull nga Skocia, ku ka një shembull konkret se si e kanë integruar dhe angazhuar me ligj këtë profesion, sepse shpesh herë ndodh që kemi bivendosje të profesionistëve që punojnë në shëndetin publik me profesionistë të shëndetit publik – të cilat janë praktikisht dy gjëra të ndryshme. Të gjithë profesionistët që punojnë për shëndetësinë janë profesionistë të shëndetit, por ekspertët të cilët merren me shëndetin publik janë të veçantë, dhe shpesh herë ky ngërç i ka bashkëshoqëruar ndër vite dhe tashmë mendoj se ka ardhur koha dhe është momenti i duhur që të marrin rolin e duhur për t'i dhënë mundësi institucioneve shtetërore shëndetësore por edhe atyre private për të funksionuar me një hap progresiv cilësor për të lehtësuar elementet që lidhen me këtë kontekst. Besoj edhe nga eksperiencia juaj një-vjeçare keni hasur dhe ndërvepruar edhe me specialistë të mjekësisë por edhe me këta specialistë të tjerë dhe besoj e shihni lehtësinë dhe impaktin që ata japin në institucionin tuaj.

Në muajin korrik - solla një shembull konkret në relacionin shoqëruar - ku patëm një rritje rroge për infermierët dhe mjekët dhe ndërkohë këta specialist për shkak të kërrij ngërçi u gjetën të papërfshirë në këtë kontekst. Ndërkohë që kjo është një kontradiktë sepse një mjek i shëndetit publik dhe një specialist i shëndetit publik bëjnë të njëjtën punë por ama pati diferencim. Duhet stimuluar edhe për t'u zhvilluar më tej. Unë ju kam bashkëngjitur edhe disa dokumenta nga Mbretëria e Bashkuar ku tregohet i gjithë krijimi i kurrikulave që ka ky vend, të cilën mund ta përshtasim edhe ne sipas nevojave të vendit për ta çuar në një nivel më të lartë. Në 2015 ky profesion është rregulluar në këtë vend dhe janë integruar të gjithë specialitetet, janë 25 mijë specialitete ekspertiza të shëndetit publik të cilat mjaft mirë mund të integrohen për një performancë më të mirë të kujdesit parësor shëndetësor.

Në vitin 2020-2025 kemi edhe strategjinë e kujdesit parësor shëndetësor në të cilën një zë shumë të rëndësishëm zë edhe fuqizimi i burimeve njerëzore. Në kujdesin parësor shëndetësor përveç mjekut të familjes që është një nga elementët thelbësor në analizë dhe diagnozë të pacientëve, janë edhe specialistët e shëndetit publik me gjithë specialitet që kanë. Kjo kërkon edhe një vëmendje nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga Ministria e Arsimit, të cilat përveçse përshtatjes me tregun të shtojnë edhe gamën për specialitetet që kanë. Janë bërë hapa, psh me Masterin e Menaxhimit Shëndetësor, por duhet bërë më shumë. Nevojat janë aty. Ne kemi edhe një shembull nga Kapitulli 27 ku përmendet një pjesë e kuadrit të shëndetit publik. Pra këta elementë kërkojnë zgjidhje, edhe ju të arrini objektivat strategjike si Ministre e Shëndetësisë duke patur ekspertë e specialistë në të gjithë institucionet. Po të kishim ecur pak më shpejt para periudhës së pandemisë mund të performonim edhe më mirë. Rastisi edhe një situatë anormale dhe në fund të 2019 për shkak të tërmetit por edhe në shkurt 2020 ne ishim para një konference të leadershipit të shëndetësisë që mbledhte të gjithë përfaqësuesit e shoqatave, të pranishëm kishim edhe Zv.Ministren Znj.Rakacolli, për të marrë eksperiencën e këtyre profesionistëve , të cilat sikurse e tha edhe kolegja jonë e SASPAC e theksoi në rrjetin që duhet të kemi midis të ngjashmëve tanë, është në Evropë sipas specialiteteve që të dimë edhe ne si NGO që të ndihmojmë më tej objektivat që ka sipas specialiteteve dhe vendin në tërësi.

E fundit, do doja të shtoja edhe diçka që e kam përsëritur dhe e kam dhe me merak, që duhet të shtojmë takimet specifike sipas grupeve të punës. E kam kërkuar disa herë, e di që ju keni shumë ngarkesë por edhe ne duhet të realizojmë disa objektiva, kështu që unë jam i gatshëm të marr pjesë në tryeza për çështje të shëndetësisë. Përpos këtij propozimi që solla sot, të cilin unë e deklaroj që ka ardhur nga të gjithë specialistët e shëndetit publik që janë të diplomuar, disa prej të cilëve punojnë në fushë e disa të tjerë jo për shkak të këtyre mungesave.

**Znj.Koçiu** – Shumë faleminderit për prezantimin, ne në fakt e kemi bërë edhe një diskutim të mëparshëm për këtë çështje. Është e vërtetë që tani na takon ne së brendshmi për të organizuar një tryezë teknike edhe së bashku me universitetin dhe të bëjmë një analizë të pozicioneve të punës, këtu nisem nga ana e administratës, dmth e pjesës administrative të institucioneve jo të ofrimit të shërbimit, për të kuptuar dhe vlerësuar pak rolin që duhet të marrë kjo lloj fushe. Është shumë e vërtetë ajo që thoni ju dhe shqetësimi që ngrini për faktin që është një profil akademik, i cili mua më ngjan si dikur edhe me punonjësit social, pra është një profesion të cilin edhe për shkak historie, kulture apo mentaliteti e zëvendësojnë edhe profesione të tjera. Pra është krijuar ideja që një profesionist të shëndetit publik apo një profesionist të shkencave sociale mund ta mbulojë edhe një profesion tjetër. Por ka nevojë për një analizë të brendshme të sektorit të administratës për të kuptuar ku mund t'i përfshijmë sepse është e vërtetë që ka prurje shumë të mira nga universitetet dhe ndërkohë nuk gjenden siç duhe në tregun e punës. E fundit do ishte për mua problemi i pagave. Ne duhet të kuptojmë njëherë së brendshmi ku pozicionohen çfarë shërbimesh ofrojnë dhe si mundet ne të marrim më të mirën prej tyre, dhe gjithsecili ta shohi përfitimin nga njëri-tjetri. Angazhimi na takon ne së brendshmi për të organizuar tryezat dhe patjetër të bëjmë edhe takime specifike të profilizuara sipas fushave.

Ne këtu e mbyllim atë çfarë kemi parashikuar në Axhendë. Fjala tani është për ju.

**Gentian Sejrani** – Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit Znj.Ministre. Në fakt për këtë mbledhje kam sugjeruar tre pika si çështje diskutimi në Axhendën e sotme, por meqenëse kolegët menduan se ishte më e nevojshme përjashtimi i tvsh-së në axhendë si një nga problematikat më të hasura, dhe shpresoj edhe me entuziazmin e treguar në mbledhje, që kjo çështje deri në fund të vitit të jetë e zgjidhur.

Unë do doja të ritheksoja edhe njëherë një çështje të cilën e kam ngritur në mbledhjen e fundvitit të kaluar, që është mungesa e konsultimeve publike. Nëse flasim për akte të cila ministritë ndërmarrin, siç është buxheti për vitin pasardhës, pra buxheti për vitin 2025, shoh që fatkeqësisht shumica e ministrive përgjegjëse nuk kanë bërë takimet me grupet e interes për planifikimin e buxheteve për buxhetimin e vitit pasardhës. Disa nga Ministritë nuk i kanë publikuar fare sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave takimet konsultuese me grupet e interes.

Së dyti, nuk e di a ka përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, por në mars të këtij viti është miratuar një udhëzim nga ana e Ministres në lidhje me rimbursimin me 5m<sup>3</sup> për familjet në nevojë për ujë, dhe përjashtimin nga tarifat dhe taksat për grupet vulnerabël, dhe fatkeqësisht po shohim që ky udhëzim nuk po zbatohet nga pushteti lokal. Do dëshiroja të kishim një relativitet nga kjo ministri sa i përket zbatimit të këtij udhëzimi.

Së treti, do doja të qendroja në një pikë të ngjashme, por që nuk ka të bëjë me rimbursimin e ujit të pijshëm por me rimbursimin e energjisë elektrike. Kemi një ligj prej disa vitesh që është miratuar, një ligj që është edhe jashtë afateve ligjore për të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të atij ligji. Bëhet fjalë për Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike ku përcaktohet edhe në këtë ligj mundësia për të subvencionuar familjet në nevojë për të pasur minimumin jetik në furnizimin me energji elektrike. Kemi hasur shpesh kundërshtime edhe nga ministria sepse nuk është e qartë se kush është Ministria përgjegjëse që duhet të mbajë regjistrin e familjeve në nevojë, Por ndërkohë që ne sot flasim për këtë problem ka familje në nevojë të cilat jetojnë pa drita, kemi edhe raste tragjike ku një nënë në mungesë të energjisë elektrike mbyti fëmijën e saj duke i dhënë gj, prandaj do doja shumë që të kisha nga ju si Ministri përgjegjëse një reagim për këtë çështje.

**Znj. Denada Seferi** – Faleminderit, ju keni padyshim shumë të drejtë për të treja pikat që prezantuat, por unë do doja të ndalesha tek pika e tretë sepse ka disa zhvillime. Pas daljes së udhëzimit ne kemi kryer dy takime me Ministrinë e Energjisë dhe Infrastrukturës, dhe kemi bashkuar dy grupet teknike të dy ministrive për të bërë të mundur jo vetëm rimbursimin me metra kub për ujin por që të përfshijmë edhe të gjithë personat vulnerabël që ne kemi te Ndhma Ekonomike dhe te personat me aftësi të kufizuar. Ndërveprimi mendohet se do të bëhet në kohë reale dhe do të bëhet direkt nga sistemet elektronike që ne kemi kshuqë përfituesit do të jenë automatikisht ata që do të kenë një kontratë me AKU apo pushtetin vendor sipas rregullave që ata kanë, dhe rimbursimi do të bëhet menjëherë nga listat e nxjerra nga këto sisteme. Pra s’do ketë më ecejake për të marrë çertifikata apo kontrata, por do të realizohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga sistemet elektronike për të gjitha grupet vulnerabël që ne i kemi sipas ligjit.

Në lidhje me rimbursimin e energjisë elektrike kjo është si çështje pak pa zot, sepse është Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës Ministria lider, por ndërkohë kemi pasur takime të posaçme në lidhje me klientin në nevojë – do të quhen të gjithë grupet vulnerabël që ne kemi të ndihmës ekonomike të personave me aftësi të kufizuar për të gjithë kategoritë e jetimëve, grave viktime të dhunës, të cilët do të marrin këto subvencione. Sapo të dali statusi i klientit në nevojë menjëherë do të vëmë në dispozicion data-bazën tonë për të bërë realisht rimbursimin e subvencionit.

**Z.Sejrani** – Kush Ministri duhet ta nxjerrë statusin?

**Znj.Seferi** – Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës në bashkëpunim me Ministrinë tonë, një grup i përbashkët pune me teknikët përkatës. Këto janë dinamikat e problematikave të ngritura nga ju.

**Znj. Fabiola Egro** – Mirëdita unë jam Fabiola Egro dhe jam anëtare e shoqërisë civile. Së pari jam shumë e gëzuar që takimet po bëhen rregullisht dhe kërkesat deri diku po na plotësohen, për të dalë nga zyra e Kryeministrit e për të qenë këtu. Dua të përgëzoj gjithashtu edhe Sekretariatit që e ka rritur shumë edhe cilësinë dhe standartin e takimeve tona duke na facilituar jo vetëm ne, por edhe Kryetarin dhe Zv.Kryetarin që duhet të përgatiteshin me gjithë kërkesat që ne nxirrnim. Tani i kemi në letër i kemi të parapërgatitura. Gjithashtu edhe përmirësimi i vizibilitetit, megjithëse unë po bëj autokritikë sepse nuk kam sjellë bio-n time për faqen e internetit të re të KKSHC, pra është vënë në rrugë të mirë. Do doja të flisja pa protokoll sepse nuk jam në Axhendë, por jam tek diskutimet, se këtu jemi një tavolinë pa gardh dhe barriera dhe është mundësia jonë që të shprehim gjithë shqetësimet dhe sfidat që shoqëria civile ka dhe të mirëkuptohemi nga të gjithë pjesëtarët e qeverisë që kemi këtu.

E filloj me kërkesën që u parashtrua nga Ladi në fillim, kërkesë të cilën e kemi ngritur të gjithë ne, dhe ndoshta le të themi nuk u mirëkuptua nga Kryetarja – që SASPAC të jetë pjesë e përhershme e kësaj tavoline, të jetë anëtare e këtij Këshilli Konsultativ. Kjo sepse do doja të rikujtoja – ne jemi këtu me 13 përfaqësues të 13 Ministrive, me Kryetare Ministren e Shëndetësisë, dhe me 13 anëtarë nga shoqëria civile. Ju e keni detyrë funksionale, ndërsa ne jemi të zgjedhur nga shoqëria civile dhe ne e kemi kontribut vullnetar. Për rrjedhojë duhet ta vlerësojmë edhe mendimin ndryshe që ne kemi, dhe të na mirëkuptoni. Mua më pëlqen që ky Këshill për pjesën e shoqërisë civile është multidimensional sepse përfshin aktorë të ndryshëm dhe fusha të ndryshme. Unë për shembull nuk kuptoj nga shëndetësia, por kur flasim për shërbimet apo kujdesin social nuk mund të kundërshtoni ju – prandaj më pëlqen të flasim pa doreza.

Pse e kërkuam SASPAC si anëtare të Këshillit? Sepse më parë kur është bërë Ligji kjo strukturë nuk ka ekzistuar, dhe tani që ne flasim SASPAC është më shumë se një ministri. Ne duam jo detyrimisht prezencën e Znj.Cano, por ju keni një skuadër shumë të mirë profesionistësh të cilët do ishte shumë mirë të dëgjonin se çfarë sfidash apo idesh kemi ne për integrimi, përfshirjen për çdo gjë, dhe të jemi bashkë në çdo hap. Në këtë Këshill ne kemi patur për shembull kundërshtime shumë të mëdha nga Kryetarja e mëparshme e këtij Këshilli, për faktin se ne kemi bërë për shembull “shadoë report” për Bashkimin Evropian, ku janë shkruar tematika që ndoshta nuk ishin konsultuar më parë edhe me qeverinë. Pra pse jo mos i konsultojmë më parë këtu dhe të ecim të gjithë me një hap, prandaj kërkuam këtë anëtarësi, sepse mendojmë që është mëse e nevojshme edhe me Kapitullin 22 që të jemi së bashku.

Sa i përket çështjes së tvsh-së, Znj. Çano përmendi që kjo është çështje dite për të por për ne është çështje vitesh tashmë dhe është një barrë shumë e madhe jo vetëm për ne por edhe me qeverinë. Tre mbledhje më parë, ku ka qenë edhe Znj.Ekonomi, ajo tha që kjo gjë mund të rregullohet shumë mirë edhe me Ministrinë e Financave të cilët po bëjnë sistemin fiskal. Kjo gjë sigurisht kërkon një studim por teknikisht mund të bëhet duke futur të gjithë organizatat e shoqërisë civile, jo vetëm për ato që marrin Projekte nga Bashimi Evropian, por mund të futet në sistemin fiskal që këto organizata janë pa tvsh, dhe kjo gjë i del edhe supermarketit të lagjja, dhe një kompani të madhe i del NIPTI dhe shkarkohet pa tvsh. Kjo është një gjë teknike për të cilën unë nuk jam shumë kompetente por përmenda çfarë është thënë këtu, dhe shpresoj shumë tek juve që do ta vini në vijë e do të gjejë zgjidhje deri në fund të vitit.

Problematika tjetër që dua ta shtroj thjesht si çështje por ndoshta sikurse folëm me Sekretariatit, do e diskutjmë për mbledhjen e ardhshme, është Regjistri Elektronik i OJF-ve në gjykatë. Është thënë që do mbyllet në qershor të 2024, por ndërsa flasim ky regjister nuk ekziston. Gjithashtu ka dalë një VKM që na detyron të dërgonim bilancin e organizatave edhe në Gjykatë, pra meqenëse do bëhej regjistri elektronik bilancat duheshin çuar edhe në Gjykatë. Unë personalisht nuk kisha pranuar të bëja pronarin përfitues dhe nga takimet për informim nga Nisma për Konsultime Ligjore na u kërkuar të dërgonim me urgjencë bilancat



se përndryshe do merrnim gjobë. Ndërkohë në Gjykatë nuk kishte informacion për këtë gjë, dhe shumica e organizatave nuk e kishte sjellë. Në këto kushte unë nuk e dërgova bilancin, po ndërkohë më vjen një mandat nga Gjykata ku më thuhej se ju nuk keni sjellë paditësin. Pas 10 diësh më vjen një letër tjetër ku më thuhet që ju e keni gjyqin e humbur. Kjo çështje pra vazhdon është shumë aktuale dhe ne kërkojmë që në mbledhjen e ardhshme ne të kemi këtu një përfaqësues të KLGJ-së të na thotë ku jemi dhe çfarë pritet të bëhet.

**Z.Thano** – për procedurë Këshilli i ka kaluar procesverbalet e fundit me problematikat që ka për t'i vijuar.

**Znj.Seferi** – po e vërtetë ne e kemi lënë për ta ndjekur këtë çështje dhe Eniana apo AMSHC mund të na bëjë një përditësim me hapat ku ndodhemi.

**Znj.Egro** – Një problematikë tjetër shumë e madhe që e hasim të gjithë ne si shoqëri civile janë bankat. Bankat po sillen shumë armiqësisht me organizatat e shoqërisë civile sepse po bëhen ndëshkuese ndaj organizatave. E para sikurse e kemi thënë edhe herë të tjera ne trajtohem si korporata, komisionet mbahen gjithashtu si korporata. Ndërkohë në kuadër të ligjit të antikorrupsionit dhe pastrimit të parave nuk lejojnë që të hapet një llogari bankare e dedikuar për projektin. Ndërkohë donator kërkon që të hapet një llogari e dedikuar për projektin e vet. Ne jemi taksapaguesit më të mirë e të rregullt në Shqipëri, sepse bëjmë bilanc, bëjmë audit të brendshëm e të jashtëm si edhe nga donatorët. Bankat janë bërë ndëshkuese sepse na bllokojnë paratë në llogari, dhe 720 organizata nuk janë regjistruar si organizata me pronar përfitues. Dhe kur ti nuk ke pronar përfitues, banka të bllokoi llogaritë, pavarësisht se ti ndërkohë si organizatë mund të kesh projekte me UN, apo BE, etj të cilët nuk e kanë fare kushtin e pronarit përfitues. Prandaj ne kërkojmë që të kemi në mbledhjen tjetër një përfaqësues nga Banka e Shqipërisë që të na e sqarojnë këtë problematikë. Shumë faleminderit për durimin.

**Z.Seferi** –përveç këtyre që u thane, problemi është që kjo kategori e 720 organizatave që nuk janë regjistruar ende për pronarin përfitues ndoshta për arsye teknike, marrin, një gjobë shumë të madhe si OJQ.

**Znj.Egro** – 400 mijë lekë është gjoba për ojq-të dhe ndërkohë gjobitet edhe pronari, unë që jam përfituese në këtë rast - kjo është edhe në konflikt me ligjin e organizatave joqeveritare që ne na trajton si entitete jopërfituese, dhe pronari jopërfitues vetë gjobitet 250 mijë lekë.

**Z.Seferi** - Pra ka një disproporcion në pjesën e gjobave dhe kuadrit rregullues. Ne jemi këtu të gjithë që përfaqësojmë shoqërinë civile dhe t'i proklamojmë të gjitha shqetësimet sipas rregullave. E para duhet një kategorizim i ve për pronarin përfitues antë sepse ojf-të nuk janë biznese, pavarësisht se trajtohen si të tilla.

**Z.Thano** – ne jemi këtu dhe kemi kohë që diskutojmë të njëjtat gjëra, ajo për të cilën duhet të binim dakort, është fakti që instrumenti i Këshillit Kombëtar për atë ligj që është aktualisht të cilin nuk kemi pse ta shajmë, rregullohet nga një ligj, i cili i jep të drejtë dhe detyra Këshillit që t'i raportojë Këshillit të Ministrave për çështje që kanë interes publik edhe në lëmin e shoqërisë civile, ku futet edhe sistemi sekondar bankar. Shpeshherë është thënë nga kryetarët e Këshillit që mbledhjet kërkojnë respektimi e procedurës formale si akt, i cili kalon më tepër institucioneve përgjegjëse. Ne kemi patur në fakt 20 pika për të diskutuar, edhe pikat e Z.Sejrani të cilat i kam këtu, mqs jam interlokutor nga pala juaj dhe mundohem të jem i barabartë për të gjithë – pra është mirë që këto prioritete të futen në mbledhjet e ardhshme dhe të vazhdojmë me të gjitha procedurat që të përcillen. Një shqetësim nga organizata të shoqërisë civile ka qenë aksesimi i historikut të proçesverbaleve dhe ne duhet ta ruajmë atë. Është ndërtuar një ëbsite i cili është i mirë por ne duhet të



ruajmë një standart që vë përballë aktorët me ekspertët në tryezë dhe i detyron aktorët që të shtyjnë përpara një axhendë proactive.

**Znj.Eniana Koçiaj** – E para, Znj.Egro shumë faleminderit për mbështetjen dhe angazhimin tuaj dhe të të gjithëve ju që keni treguar me Këshillin. Ndërkohë unë doja të bëja vetëm një saktësim të vogël, unë propozova më shumë për t’u ngritur si çështje për mbledhjen e ardhshme problematika që keni patur ju me bankat, duke qenë se ne na duhet të konsultohemi me shumë aktorë dhe normalisht nuk e kishim kohën në dispozicion për këtë mbledhje.

Ndërkohë sa i përket KLGJ-së, është përsëri një çështje e vërtirë siç është çështja e përjashtimit të tvsh-së që folëm më parë me SASPAC-un ku janë të përfshirë disa institucione në të njëjtën kohë, që janë KLGJ, AKSHI dhe Gjykata e Tiranës. Tani sipas Gjykatës së Tiranës dhe KLGJ-së, 90 % e dosjeve janë të dixhitalizuara - pra procesi nga ana e tyre është pothuaj i mbaruar. Ndërkohë procesi ka mbetur tek e-albania – në momentin e parë që e-albania bën pasqyrimin e ndryshimeve atëherë do përfundojë si proces – pra ka mbetur pak tek AKSHI si fazë finale. Ne u përpoqëm të lidhemi me ta por nuk kemi arritur të marrim një informacion prej tyre. E meqenëse jemi në këtë tavolinë dialogu ndoshta kemi nevojë edhe për ndihmën e nivelit pak më të lartë politik që të mund të flasim edhe me ta e ta shtyjmë përpara drejt përfundimit këtë shqetësim. Por nga ana e KLGJ-së dhe Gjykatës së shkallës së parë Tiranë procesi është pothuaj i përfunduar prej tyre. Nuk morëm një afat përfundimtar kur mund të mbarojë, shpresojmë brenda fundit të vitit, por me sa kuptova kjo gjë varet edhe nga AKSHI.

**Znj.Egro** – faleminderit Eniana për ndjekjen, por mund të shkojmë më tej që të ecim përpara. Unë jo pa qëllim thashë një kazuz, me një kazuz ndryshohen edhe ligjet e jo më të përshpejtohet ky proces regjistrimi. Ju lutem herën tjetër mos ta lëmë vetëm në ndjekjen tuaj këtë çështje, por të kemi edhe një përfaqësues me të cilin mund të komunikojmë.

**Z.Thano** – e kemi patur në mbledhjen e fundit përfaqësuesin nga KLGJ.

**Znj.Cano** - shpeshherë i kalohet çdo përgjegjësi AKSHI-t, Sigurisht që do i pyesim përfaqësuesit e AKSHI-t ku është procesi dhe problemi se kolegë i kemi, por shumicën e kohës, se njoh edhe procese të tjera ku përfshihen institucione të tjera të pavarura e të varura, nuk i mbyllin vetë etapat dhe thonë që ka ngelur tek AKSHI. Është thjesht informacion të cilin do e marrim e do shohim ku jemi. E rëndësishme është të ketë angazhime nga të gjitha palët për të shtyrë përpara çështjet.

**Z.Albin Gega** – faleminderit Ministre, unë dua të marr shkurtimisht pak fjalën se edhe koha ka kaluar tashmë. Dua të flas pak për projektin e Garancisë Rinore I cili është një projekt shumë i madh, projekt të cilin edhe Drejtoresha e SASPAC ka dijëni sepse është një projekt të cilin e kemi punuar bashkërisht. Ky është një projekt shumë i madh rreth 63 milion euro, ku 52 milion janë grant i BE dhe 12 të tjera janë investim direkt i qeverisë nga buxheti i shtetit. Në këtë projekt ka rol shumë të madh edhe shoqëria civile. Me urdhër të Kryeminsitrit është ngritur një grup ndër-ministror në të cilin është përcaktuar që shoqëria civile të ketë një rol shumë të rëndësishëm në “outreach-in” e të rinjve. Projekti i garancisë rinore është oferta për punësim apo aftësi për të rinjtë nga mosha 15-29 vjeç, dhe organizatat e shoqërisë civile do të jenë ato që do të gjejnë të rinjtë e do t’i sjellin ata pranë zyrave të punësimit. Kjo do të thotë që është një përfshirje e drejtpërdrejtë e juaja, dhe pse jo edhe një mundësi për të patur ju qasje në këtë projekt dhe për të qenë pjesë në këtë projekt. Lajmi i mirë është që drejtorja përkatëse ka marrë akreditim të plotë nga misioni i BE-së në Shqipëri dhe

Bruksel. Jemi shumë afër fillimit të këtij projekti, me shumë mundësi do fillojë në fillim të vitit tjetër. Ju ftojme të jeni pjesë e këtij projekti dhe ta ndiqni këtë projekt.

**Z.Thano** – a ka rol AMSHC në këtë projekt?

**Znj.Eglantina Bardhi** – a mund të na thoni diçka më shumë për këtë projekt dhe të na thoni si mund të përfshihet shoqëria civile në të? Ne duhet thjesht të identifikojmë të rinjtë në moshën përkatëse dhe t'i sjellim pranë zyrave të punësimit?

**Z.Albin Gega** – Për të ndarë institucionet që menaxhojnë projektin - është Ministria e cila menaxhon, pastaj CFCU që bën dhe ndjek gjithë procedurën, dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Afësi është institucioni i cili ndjek dhe zbaton projektin në terren. Sa i përket planit operacional, ai zbatohet nga Agjencia, dhe jo nga Ministria, pra jam jashtë kompetencave të mia, por ajo që mund t'ju them është se ka një plan i cili detajon në mënyrë konkrete përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile duke filluar me projektin dhe kërkimin e të rinjve, por duke qenë edhe pjesë e projektit për “outreach” sa më shumë të të rinjve. Sa më shumë të rinj të sillen, dhe këta të rezultojnë të sukseshëm, sepse këta janë të rinj “net” dmth nuk janë as në punësim as në aftësim e as në shkollë. Pra sa më shumë raste të sukseshme ka, aq më shumë projekti validohet nga askpeti ekonomik. Do t'ju dërgoj të gjithë informacionin e nevojshëm sepse e shoh që ka edhe interes.

**Znj.Koçiu** – rezervuat takimin e ardhshëm për mbledhjen e rradhës. Dhe nëse është me interes siç po e shohim këtu, duhet bërë patjetër një prezantim i detajuar, se edhe një nga vërejtjet që nuk i dhashë shpjegim dhe për të cilën më tërhoqëi vërejtje N/Kryetari, është përse nuk u shpreha për konsultimet publike.

Konsulimet publike pak po e sigurtë është që po ndodhin më shpesh. Nuk është një proces me të cilin ne ishim mësuar më parë si ushtrim ta bënim shpesh, por unë besoj se secili nga institucionet kur ka një draft ligj, një strategji, një dokument që prek aktorë apo edhe akte rregullatore kalon në një proces konsultues. Ne kemi platformën elektronike të konsultimit publik, unë nuk e di sa vizibël apo shteruese është, pra mjafton si mjet për konsultimet. Unë po shtroj një informacion të përgjithshëm – sa i përket buxheteve, secila Ministri kryen proceset e veta të konsultimit.

**Z.Sejrani** – sipas udhëzimit të Ministrisë së Financave, kjo gjë duhet të ndodhte në prill, për buxhetin e shtetit për vitin 2025.

**Znj.Koçiu** - Në janar futet ligji i ri i buxhetit. Besoj e keni fjalë për buxhetin 3-vjeçar.

**Z.Thano** – në këtë proces duhet të kemi parasysh edhe rolin e Parlamentit. Sigurisht që shtrohet edhe këtu si diskutim por duhet të diskutjmë edhe për hallakt e tjera paralele në këtë proces.

**Znj.Egro** – Për fushat që ne punojmë, dhe sot vi nga një takim në Ministrinë e Drejtësisë, vizibiliteti është shtuar gjithnjë e më shumë, konsultimet kanë filluar të jenë shumë më të rregullta. Pastaj se si bëhen dhe sa ndiqen apo çfarë efekti kanë, kjo pastaj duhet parë dhe duhet monitoruar.

**Znj.Koçiu** – nëse ne si institucione do kemi rekomandime nga kushdo në platformë, ne jemi të detyruar të kthejmë patjetër përgjigje - na e kërkon edhe relacioni shoqëruar i vetë aktit. Por nga ana tjetër duhet thënë edhe që të gjithë aktorët që kontribuojnë në rekomandime duhet t'i ngrenë kapacitetet, sepse për hir të së vërtetës vetëm rekomandime që nuk vinë – vinë ca rekomandime të karakterit individual , që përfaqësojnë

ca interesa të ngushta , dhe kjo sigurisht nuk ndodh gjithmonë. Por është një proces i dyanshëm, sikurse institucionet duhet të mësohen dhe përgatiten për këtë lloj bashkëbisedimi virtual, edhe pala tjetër duhet të përgatitet për këtë proces. Dhe këtu flas edhe për institucione, individë sepse nuk janë vetëm organizatat e shoqërisë civile të përfshira në këtë mes. Pra vinë disa komente të vakta, të mjegullta, të pasqarueshme, sepse ne na duhet të bëjmë oponencën ose komentin në këmbim por nuk ja bëjmë dot nga cektësia e argumentit, pra e kemi të vështirë të japim edhe argument për t'ja marrë ose jo në konsideratë.

**Z.Thano** – do doja të thoja edhe dy gjëra të fundit për mbyllje. E para në lidhje me datën e takimit të ardhshëm, unë do propozoja mesin e dhjetorit ndoshta datën 11 dhjetor, gjithmonë para pushimeve.

Dhe e dyta, është mirë që herës tjetër të punojmë me një kalendar aktivitetesh që t'i kemi rezultatet më të matshme, ky kalendar përmban aktivitetet që duhet të bëjë KKSHC përgjatë vitit. Sikurse propozuam ëorkshopin kombëtar për 2023 dhe e bëmë atë. Bëhet fjalë për 2025-ën.

**Znj.Koçiu** – edhe ne për ta mbyllur nëse s'ka diskutime të tjera, dhe për ta shuar pak debatin kë e ftojme dhe si e ftojme – po shihja pak nenin 6 të Ligjit aktual që për hir të së vërtetës kupton nevojën që ka për të amenduar këtë ligj. Edhe për terminologjinë e përdorur edhe nga teknika legjislative, ne sot për shembull nuk i vendosim më institucionet me këto emërtesa se historia ka treguar se nëse ti bën një ndryshim në emërtesë të del e pavlefshme e gjithë pika dhe neni. Pra do ishte mirë që të shkruajmë institucionet përgjegjëse për fusha të caktuara, dhe kjo do zgjidhte edhe diskutimin që bëmë më parë për SASPAC. Ndërkohë ju lutem ndihuni të lirë që për çdo institucion që s'është pjesë e këtij Këshilli, dhe ligji, që ne t'i ftojme dhe institucionet jam e sigurtë që përgjigjen. Ne sot për shembull kishim ftuar edhe zyrën e Kryenegociatorit, të cilët ishin shumë të interesuar për të ardhur e për të folur, e madje për të shteruar edhe diskutimin që kemi mes nesh kush do e marrë funksionin për këtë Këshill.

**Z.Thano** – meqë jemi këtu do doja të dija nëse ju si institucion do vazhdoni të keni gatishmërinë dhe dëshirën për ta vazhduar udhëheqjen e Këshillit, se është shumë e rëndësishme edhe për ne për ta diskutuar.

**Znj.Koçiu** – Kjo është për t'u diskutuar, për aq kohë sa ishte e vendosur në axhendë, ne e bëmë edhe si diskutim me zyrën e Kryenegociatorit. Ne mund të ngremë një strukturë këtu e vendosim çfarë duam të bëjmë, dhe ecim përpara. Edhe në kuadër të procesit të integritetit të gjitha këto diskutime duhen sqaruar. Me premtimin që në mbledhjen e radhës do kemi vijuar edhe me çështjet e lëna pezull dhe do bëjmë një raportim të shkurtër ku jemi me çështjen e tvsh-së, por edhe me një axhendë sipas pikave që kemi dhe që s'u diskutuan në këtë mbledhje, por dhe për çdo gjë të re që do dalë rrugës këto dy muaj, ju lutem ndihuni të lirë të na i propozoni që t'i ndjekim ato. Nëse ne do kemi komunikimin më të shpeshtë është e sigurtë që shumë çështje do të marrin zgjidhjen e nevojshme.

E deklaroj mbledhjen e mbyllur.